



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: _____

Datë: ___/___/_____

Senati i Universitetit të Prishtinës, bazuar në nenin 19 pika 1 të Statutit dhe të nenit 17-24 të Rregullores së punës së Senatit nr. 1/131 të datës 1.6.2015, në mbledhjen virtuale të datës 14.07.2020, mori këtë

V E N D I M

- I. Shpallet njoftimi për aplikim të kandidatëve për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues nga radhët e personelit akademik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.
- II. Anëtari i ri i Këshillit Drejtues zgjedhet për mandatin e mbetur, respektivisht për periudhën e cila fillon pas zgjedhjes, nga dita e verifikimit të mandatit nga ana e Këshillit Drejtues dhe përfundon me datë 30 shtator 2022.
- III. Secili anëtar i personelit akademik të Universitetit në marrëdhënie të rregullt pune ka të drejtë të kandidohet për anëtar të Këshillit Drejtues të Universitetit, me përjashtim të atyre kandidatëve të cilët kanë pasur dy mandate.
- IV. Përjashtimisht nga alineja 3 e këtij neni, nuk mund të kandidohen për anëtarë të Këshillit Drejtues për mandatin e përcaktuar si në pikën II të këtij vendimi: rektori, prorektorët, dekanët, prodekanët, dhe anëtarët e Senatit (neni 18 i Rregullores nr. 1/131 të datës 1.6.2015).
- V. Dokumentacioni për kandidim dorëzohet në formë elektronike në adresën kandidimikd@uni-pr.edu, nga data 15-21 korrik 2020, në ora 15.30. Dokumentacioni i dërguar pas orës 15.30, nuk do të merret në shqyrtim nga Komisioni.
- VI. Kandidatët duhet të dorëzojnë një letër motivimi dhe CV-në.
- VII. Me të përfunduar të procedurës së kandidimit, komisioni zgjedhor prej tre anëtarësh i zgjedhur nga Senati i UP-së, shqyrton dokumentacionin e kandidatëve të paraqitur.
- VIII. Komisioni zgjedhor përcakton nëse kandidatët e paraqitur i plotësojnë kushtet nga neni 18 i kësaj Rregulloreje, si dhe nëse dokumentacioni i aplikimit është i kompletuar.
- IX. Lidhur me dokumentacionin e shqyrtuar, komisioni i paraqet raport Senatit, me propozim të listës së kandidatëve që i plotësojnë kushtet për kandidim.

- X. Raporti i komisionit zgjedhor bashkë me dokumentacionin e kandidatëve në rastin e zgjedhjeve të parakohshme i dërgohet anëtarëve të Senatit të paktën një ditë para mbajtjes së mbledhjes për zgjedhjen e 1 anëtari të Këshillit Drejtues.
- XI. Në fillim të mbledhjes zgjedhore, Senati shqyrton raportin e komisionit zgjedhor dhe përcakton listën përfundimtare të kandidatëve që i plotësojnë kushtet nga neni 18 i kësaj Rregulloreje.
- XII. Zgjedhja e anëtarit të Këshillit Drejtues bëhet me votim të fshehtë i cili realizohet në mënyrë virtuale përmes programi të veçantë në kuadër të SEMS.
- XIII. Në rast se asnjë prej kandidatëve nuk fiton numrin e nevojshëm të votave në radhën e parë të votimit, atëherë procesi do të përsëritet për dy kandidatët të cilët kanë më së shumti vota, në një afat jo më vonë se 30 minuta.
- XIV. Procedurat rreth numrit të nevojshëm të votave do jetë në përputhje me kriteret e Rregullores së punës së Senatit nr. 1/131 të datës 1.6.2015.
- XV. Vendimi duhet të publikohet në tabelat e shpalljeve të njësive akademike dhe në faqen zyrtare elektronike të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” www.uni-pr.edu

Vendimi t’u dorëzohet:

1. Anëtarëve të Senatit,
2. Anëtarëve të komisionit zgjedhor,
3. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së,
4. Zyrës së TI-së,
5. Arkivit të UP-së dhe
6. Publikohet në www.uni-pr.edu.

Kryesues i Senatit të Univiversitetit të Prishtinës




Prof. Dr. Marjan Dema, Rektor